- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 **Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 **Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 **Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 **Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 615-24-9394-5-2-1/C1094

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 21 904,58 me vlefshëri prej 210 ditësh duke filluar nga data e nënshkrimit nga ana e të dy palëve
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar</p> <p>e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite nga koha e nënshkrimit të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë sipas planit dinamik e që është 180 ditë
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit

		përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit Caktohet nga ZKA brenda 3 dite
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: NA
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: NA
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 365 ditë nga koha e pranimit të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Komuna e Podujevës</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega Podujeve në pajtim me ligjin në Kosovë. ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>a) Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

PROJEKTI : Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore (renovimi i objektit të teatrit të qytetit)

PARAMASA ME PARALLOGARI

1 PUNËT E PËRGATITORE					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Installimi i zyrës së përkohshme në punishtë sipas rregullave dhe kërkesave për menaxhimin e punëve ndërtimore.	copë	1.00	€ 2,000.00	€ 2,000.00
2	Sinjalizimi i punishtes (sipas standardeve të ndërtimit) hyrje daljeve në kantier, duke përfshirë edhe montimin e tabelës informuese me emrin e projektit, investitorit, punëkryesit etj.	komplet	1.00	€ 600.00	€ 600.00
3	Installimi i përkohshëm i rrjetit elektrik, ujësjellësit, kanalizimit dhe ndriçimit i kantierit.	komplet	1.00	€ 400.00	€ 400.00
nëntotali					€ 3,000.00

2 PUNËT E DEMOLIMIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Demolimi komplet i kulmit ekzistues, duke përfshirë tregullat, konstrukcionin nga druri komplet me të gjitha shtresat, demolimi i oxhakut ekzistues, ullukët horizontal dhe vertikal, rrufepërfaqesit etj., si dhe të bëhet pastrimi i tërësishtëm i pllakës për izolimet vijuese. Materiali i demouar të deponohet në deponinë që e cakton AK	m ³	1.00	€ 90.00	€ 90.00
2	Demolimi dritareve ekzistuese me një kujdes të veçantë që të mos dëmtohen dhe të deponohen në deponinë që e cakton AK. Dritaret kanë dimensione të ndryshme.	copë	18.00	€ 140.00	€ 2,520.00
3	Demolimi detyrës ekzistuese me një kujdes të veçantë që të mos dëmtohet dhe të deponohet në deponinë që e cakton AK.	copë	9.00	€ 180.00	€ 1,620.00
nëntotali					€ 4,230.00

3 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Heqja e shtresës së humurit në tërë sipërfaqen dhe transporti gjerë në vendin e caktuar nga ana e investitorit.	m ³	31.30	€ 10.00	€ 313.00
2	Gërmimi i dheut (kategoria II deri III) me makinë për themelet shiritore dhe të veqanta. Në përfundim të parashihet, planifikimi dhe nivelimi sipërfaqes së dhaut pas gërmimit. Barta e dheut të tepërt bëhet deri në deponinë e parapërdhur (jo më larg se 10 km).	m ³	63.48	€ 5.00	€ 317.40
3	Planifikimi i terrenit me saktësi +/-3 cm nën themele dhe dysheve me mesatare të gërmimit 0.05 m ³ /m ² me largimin e materialit deri në deponi.	m ²	105.81	€ 5.00	€ 529.05
4	Furnizimi, transporti, shtrirja/mbushja dhe ngjeshja e zhavorrit (tampon nga guri i lthyer me granulometri 0-63 mm dhe 0-31.5mm), me trashësi tmin=20cm. Vendoset nën themelet. Moduli i deformimit Mv=50 Mpa. Llogaria nënkupton vëllimin e ngjeshur të tamponit.	m ³	21.16	€ 10.00	€ 211.60
6	Furnizimi, transporti, shtrirja/mbushja dhe ngjeshja e zhavorrit të pa përpunuar (D<63mm dhe 0-31.5mm) apo dheut zhavorrik me përbërje të madhe zhavorrike i përshatshëm për ngjeshje, me trashësi për ngjeshje në shtresa max25 cm. Vendoset për mbushje në mes të këthave të themeleve shiritore të përdhësës dhe nën pllakën e dyshemesë. Moduli i deformimit Mv=40 Mpa. Llogaria nënkupton vëllimin e ngjeshur të tëmponit.	m ³	62.39	€ 10.00	€ 623.90
nëntotali					€ 1,994.95



4 PUNËT E BETONIT DHE BETONARMESE					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cnimi	Shuma
	Në çmime njësi duhet të llogariten të gjitha punët në lidhje me përgatitjen e kallëpeve, montimin dhe përforcimin e tyre si dhe skelet e nevojshme për kryerjen e operimeve të cilat ndërliidhen jo vetëm me punët e kallëpimit por edhe të betonimit të elementeve strukturore relative dhe punë tjera të ngjashme. Të gjitha punët në lidhje me procedurat e prodhimit të betonit, vibrimit, menyrës së betonimit, mirëmbajtjes, etj., duhet të jenë në përputhje me normat EN 206 (EC-2).				
1	Furnizimi, transporti me beton C-16/20 (MB-20) dhe punimi i shtresës rrafshuese me t=5 cm mbi zhavorrin e ngjeshur të themeleve shiritore si shtresë rrafshuese për punët e armaturës, sipas detaleve për ekzekutim. Në çmimi të përfshihen edhe nivelimi, rrafshimi dhe përpunimi i kësaj shtrese nga betoni i dobët të cilat vendosen nën themele .	m ³	5.29	€ 98.00	€ 518.42
2	Furnizimi, transporti, kallupimi dhe betonimi i themeleve shiritore ,me klasë të betonit C25/30.	m ³	67.16	€ 98.00	€ 6,581.68
3	Furnizimi, transporti, kallupimi dhe betonimi i pllakës së dyshemesë të përdhësës me beton të papërshkueshëm nga uji, t=18cm. Betoni C25/30. Në llog. edhe betonimi i shkallëve të jashtme	m ³	34.74	€ 98.00	€ 3,404.52
4	Furnizimi, transporti, kallupimi dhe betonimi i shtyllave dhe trajeve (duke përfshirë edhe trajet mbi dyerë , dritare dhe të atikës), me beton të klasës C 30/37.	m ³	18.32	€ 98.00	€ 1,795.36
5	Furnizimi, transporti, kallupimi dhe betonimi i pllakave (meskatit) t=20cm , me beton të klasës C 25/30.	m ³	38.34	€ 98.00	€ 3,757.32
6	Furnizimi, transporti dhe betonimi i hapësirës së deposë me fer beton t=10cm , si shtresë finale me beton të klasës C 25/30 . Të llogaritet edhe armimi me rrjetë Q335 si dhe impregnimi i ngjyrës në beton të cilën e cakton AK	m ³	4.35	€ 150.00	€ 652.50
PUNËT E BETONIT DHE BETONARMESE TE PARAHYRJA E TEATRIT					
7	Furnizimi, transporti ,kallupimi dhe betonimi i themeleve të veqanta ,me klasë të betonit C25/30. Paraprakisht demoliimi , përkatesisht prerja e pllakës akzistuese për punimin e themeleve . Eshhtë i llogaritur edhe te themelet dhe bazamenti i shtyllave dekorative .	m ³	4.32	€ 95.00	€ 410.40
8	Furnizimi, transporti, kallupimi dhe betonimi i pllakës së dyshemesë së parahyrjes me beton të papërshkueshëm nga uji, t=18cm. Betoni C25/30 . Në llog. edhe betonimi i shkallëve të jashtme si dhe rampa (pjerrina)	m ³	4.60	€ 98.00	€ 450.80
9	Furnizimi, transporti, kallupimi dhe betonimi i shtyllave dhe trajeve , muri i atikës me traun mbi të me beton të klasës C 30/37.	m ³	6.60	€ 98.00	€ 646.80
10	Furnizimi, transporti, kallupimi dhe betonimi i pllakës së parahyrjes t=20cm , me beton të klasës C 25/30. Vërejtje: (për pozicionet 7,8,9 dhe 10) gërmimi dhe armimi është i përfshirë në pozicionet e gërmimit dhe armimit	m ³	6.24	€ 98.00	€ 611.52
				nëntotali	€ 18,829.32



5 PUNËT ARMIRUESE					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Çeliku për armaturë do të jetë i brinjëzuar përveç nëse ipen indikacione tjera nga organi mbikëqyrës. Çeliku për armaturë do të aplikohet në përputhje të plotë me normat ENV 10080 si dhe të posedon me karakteristikat që vijojnë: Vlera karakteristike e kufirit të rrjedhjes (yield strength characteristic value) fyk=500 N/mm ² . Madhësitë e diametrit të përputhen me vlerat nominale sipas ENV 10080. Furnizimi, prerja, lakimi dhe montimi i shufrave të armaturave duhet të bëhet sipas formave të paraqitura në detalet teknike si dhe të verifikohen në vendëpunishte . Çeliku për armaturë do të aplikohet në përputhje të plotë me normat ENV 10080. Klasa e duktilitetit (ductility class) B e lartë (high ductility) B 500 B.Furnizimi, prerja, lakimi dhe montimi i armaturave fije dhe rrjete, sipas detaleve të projektit. Kualiteti i armaturës S-500B (fyk=500 MPa). Diametri i shufrave qe do te punchen është nga Ø6mm ~ Ø16 mm. Në çmim të llogaritet edhe teli që nevojitet për lidhje të armaturave dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion.	kg	16620.3	€ 0.98	€ 16,287.89
nëntotali					€ 16,287.89

6 PUNËT E IZOLIMIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi, transporti, punimi dhe vendosja e hidroizollimit horizontal me lyerje të ftohtë (bitult) dhe një shtresë të kondorit d=4mm mbi pllakën e dyshemesë dhe rrokullis së anax-it.	m ²	234.42	€ 4.50	€ 1,054.89
2	Furnizimi, transporti, punimi dhe vendosja e hidroizollimit horizontal me tri shtresa të kondorit d=4mm mbi pllakën e përdhësës (anex-B).	m ²	193.02	€ 4.50	€ 868.59
3	Furnizimi, transporti, punimi dhe vendosja e hidroizollimit horizontal me tri shtresa të kondorit d=4mm mbi pllakën e katit 1 (objektit ekzistues).	m ²	98.09	€ 4.50	€ 441.41
4	Furnizimi, transporti, punimi dhe vendosja e hidroizollimit horizontal me një shtresë të kondorit d=4mm mbi pllakën e parahyries.	m ²	29.50	€ 4.50	€ 132.75
5	Furnizimi, punimi dhe vendosja e hidroizollimit horizontal me lyerje të ftohtë (bitult) mbi pllakën e dyshemesë dhe mureve të nryeve sanitare.	m ²	58.42	€ 3.50	€ 204.47
nëntotali					€ 2,702.11

7 PUNËT E MURATIMIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi, transporti me material dhe muratimi i mureve te jashtme me t=25cm dhe të brendshme me t=20cm me blloka të argjllës (i llogaritur edhe llaqi vazhdues) . Në llogari hyni edhe muratimi i atikës te objekti ekzistues , muratimi te foajeu etj .	m ³	84.55	€ 110.00	€ 9,300.50
2	Furnizimi, transporti me material dhe muratimi i mureve me t=15cm me blloka të argjllës (i llogaritur edhe llaqi vazhdues) .	m ³	4.23	€ 120.00	€ 507.60
nëntotali					€ 9,808.10

8 PUNËT E SUVATIMIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi, transportimi dhe suvatimi i mureve dhe plafonit me llaq MP 75 në dy shtresa me spërkatje paraprake me bazë . Në çmim llogariten edhe këndoret metalike që vendosen në kënde.	m ²	620.74	€ 3.00	€ 1,862.22
2	Furnizimi, transportimi dhe suvatimi i mureve dhe plafonit me llaq vazhdues në pjesët e toaleteve me përpjesë 1:2:6 në dy shtresa me spërkatje të mëparshme me llaq të holluar çimentoje .Në çmim llogariten edhe këndoret metalike që vendosen në kënde.	m ²	141.18	€ 2.00	€ 282.36
nëntotali					€ 2,144.58



9 PUNËT E GLETIT DHE NGJYROSJES						
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma	
1	Furnizimi, transporti i materialit dhe gjetimi i murit deri në tri shtresa përkatësisht deri në përgaditjen e sipërfaqes për pranimin e ngjyrës.	m ²	604.50	€ 2.50	€	1,511.25
2	Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja me ngjyrë akrile për mure dhe plafone në dy shtresa, lloji dhe ngjyra caktohen sipas kërkesës së investitorit dhe në konsultim me projektantin , prodhuesit JUB , Kraft, Relius, Rofix , ose të kategorizimit të njëjtë. Paraprkishtë ngjyrosja me ngjyrë bazë . Llogaria të bëhet për m ² të sipërfaqes së punuar .	m ²	761.92	€ 1.00	€	761.92
3	Furnizimi, transporti i materialit dhe gjetimi i murit deri në tri shtresa përkatësisht deri në përgaditjen e sipërfaqes për pranimin e ngjyrës. Paraprkishtë lryerja me bazë . Përdoret te objekti ekzistues .	m ²	546.18	€ 2.50	€	1,365.45
4	Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja me ngjyrë akrile për mure dhe plafone në dy shtresa, lloji dhe ngjyra caktohen sipas kërkesës së investitorit dhe në konsultim me projektantin , prodhuesit JUB , Kraft, Relius, Rofix , ose të kategorizimit të njëjtë. Paraprkishtë ngjyrosja me ngjyrë bazë . Llogaria të bëhet për m ² të sipërfaqes së punuar . Përdoret te objekti ekzistues dhe te teatrit	m ²	822.40	€ 1.00	€	822.40
nëntotali					€	4,461.02

10 PUNËT E DRURIT						
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma	
1	Furnizimi , transporti dhe montimi i konstruksionit të drurit për kulm nga lënda cilësore e drurit të kategorisë së I-rë me tërë materialin e nevojshëm si: mahitë 10/12 (cm) , dërrasat izoluese 1.2 cm , folja difuzive , kontralistelat, listellat , të gjitha pjesët përcjellëse për ankerim , shtangim si dhe me ankerimin në konstruksion në ramje me detaje sipas projektit .Llogaria për m ² të sipërfaqes horizontale të kulmit. Përdoret te objekti ekzistues dhe te depoja .	m ²	141.15	€ 35.00	€	4,940.25
nëntotali					€	4,940.25

11 PUNËT E MBULESËS						
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma	
1	Furnizimi dhe vendosja e mbulesës së kulmit në objekt , mbulesa duhet të jetë "Sandwich" me trashësi 5cm (llogaria për m ² të sipërfaqes horizontale të kulmit) . Përdoret te objekti ekzistues te parahyrja e teatrit dhe te depoja	m ²	165.15	€ 18.00	€	2,972.70
nëntotali					€	2,972.70



12 PUNËT E ZDRUKHTARISË					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi	Shuma
1	Furnizimi, transporti, punimi dhe montimi i dritareve dhe durrëve nga profilet e aluminit formik të elokuara me ngjyrë (ë cakton AK), alumini i tipit M11500 ose të ngjajshme. Xhami termopan 6+12+6, xhami i jashtëm 6mm katër stinor, xhami i brendshëm lowe 6mm, hapësira e vakuumit e mbushur me gaz argon. Dritaret me hapje ventus nga brenda me dorëza të gjata për hapje, me gërrshërë siguroese, gomë perimetrike EPDM, dorëza dhe mentesha kualitative. I tërë pozicioni të punohet dhe montohet sipas projektit kryesor/skemës se hapjeve dhe udhëzimeve. Nuanca të jetë e zezë, ose antracit.				
	Dritare dim: 80/220 (cm) (te objekti ekzistues)	copë	9.00	€ 190.00	€ 1,710.00
	Dritare dim: 120/220 (cm) (te objekti ekzistues)	copë	2.00	€ 250.00	€ 500.00
	Dritare dim: 60/60 (cm) (te objekti ekzistues)	copë	4.00	€ 45.00	€ 180.00
	Dritare dim: 360/220 (cm) (te objekti ekzistues)	copë	1.00	€ 850.00	€ 850.00
	Dritare dim: 180/220 (cm) (te objekti ekzistues)	copë	3.00	€ 450.00	€ 1,350.00
	Derë dim: 110/260 (cm) (te objekti ekzistues - me mbi ndriqim)	copë	1.00	€ 320.00	€ 320.00
	Dritare dim: 120/220 (cm) (te anex-i)	copë	3.00	€ 290.00	€ 870.00
	Dritare dim: 80/60 (cm) (te anex-i)	copë	3.00	€ 60.00	€ 180.00
	Dritare dim: 120/80 (cm) (te anex-i)	copë	2.00	€ 100.00	€ 200.00
	Dritare dim: 120/160 (cm) (te anex-i dhe te fozjeu i teatrit)	copë	4.00	€ 230.00	€ 920.00
	Derë dim: 90/210 (cm) (te objekti anex-i - e gëllëzuar)	copë	1.00	€ 385.00	€ 385.00
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i durrëve të brendshme nga prodhuesit "HORMAN", "NOVOFORM", apo i ngjajshëm nga flatët e metalit i plastifikuar. Krahu i derës të jetë me mbështjellësit metalik t=0,8mm të mbushura me termoizolim Proparn, trashësia e krahit të derës t=4cm. Shtukot/kornizat të jenë metalike t=2,2mm, mveshje e murit (20-30 cm), dhe lartësi sipas dim. në projekt duke përfshirë ndriqimin brenda kornizës si dhe të pajtura me gomë perimetrike, mentesha tri pjesëshe, mekanizmi mbyllës dhe dorëzë inox; me izolim akustik: të akorduar sipas DIN EN ISO 140-3 (≥32dB). Shtuko/kornizat dhe paneli i derës me nuanca RAL: 9007. Durrët në lartësi të hapjes finale 210cm. Të gjitha durrët dhe materialet e tyre duhet të jenë me standarde të kualitetit sipas ISO 9001.				
	Durrë dim: 90/210 (cm) (te objekti ekzistues)	copë	6.00	€ 320.00	€ 1,920.00
	Durrë dim: 70/210 (cm) (te objekti ekzistues) PVC	copë	3.00	€ 320.00	€ 960.00
	Durrë dim: 90/210 (cm) (te anex-i)	copë	4.00	€ 320.00	€ 1,280.00
	Durrë dim: 80/210 (cm) (te anex-i)	copë	6.00	€ 320.00	€ 1,920.00
	Durrë dim: 300/300 (cm) (te anex-i)	copë	2.00	€ 400.00	€ 800.00
	nëntotali			€	14,345.00



18 PUNËT E KERAMIKËS					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi dhe montimi i pllakave të dyshemesë në toaleta dhe kthina të sanitarisë nga porcelani Klasi I parë, dy herë të pjekura . Fortësia min. 50N/mm2 .Rezistente ndaj abrazionit .Rezistente ndaj ngricave . Absorbimi i ujit duhet të jetë me e ulët se 0.5% . Rezistente ndaj acideve dhe bazave .Vendosja e pllakave duhet të bëhet konform Standardit EN 13888.Ne çmim duhet të përfshihen edhe këndoret e Aluminit,ngjitësi, dhe të gjitha punët tjera të nevojshme për të arritur produktin final . Te objekti ekzistues të llogaritet edhe demontimi i pllakave ekzistuese , nivelizimi dhe izolimi i ftohtë i dyshemesë si dhe riparimi i gypave të kanalizimit dhe ujësjellësit nëse janë	m ²	30.50	€ 20.00	€ 610.00
2	Furnizimi dhe montimi i pllakave të murit në toaleta dhe kthina të sanitarisë nga porcelani Klasi I parë, dy herë të pjekura . Fortësia min. 50N/mm2 .Rezistente ndaj abrazionit .Rezistente ndaj ngricave , Absorbimi i ujit duhet të jetë me e ulët se 0.5% . Rezistente ndaj acideve dhe bazave .Vendosja e pllakave duhet të bëhet konform Standardit EN 13888.Ne çmim duhet të përfshihen edhe këndoret e Aluminit,ngjitësi, dhe të gjitha punët tjera të nevojshme për të arritur produktin final . Te objekti ekzistues të llogaritet edhe demollimi i pllakave ekzistuese dhe izolimi i ftohtë i një pjese të murit .	m ²	128.50	€ 24.00	€ 3,084.00
				nëntotali	€ 3,694.00

19 PUNËT MAKINERIKE					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi dhe montimi i njësive të brendshme dhe jashtme individuale për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, prodhuesi Midea ose të ngjajshme me karakteristika: SPLIT UNIT DC INVERTER Modeli Indoor/Outdoor: MSAGDU-24HRFN8 / MOX401-24HFN8 Furnizim me energji elektrike (V/Ph/Hz) (Indoor): 230, 1+N, 50 Kapaciteti nominal për ftohje (min-max): 7.03 (3.01-8.79) kW Kapaciteti nominal për ngrohje (min-max): 7.33 (1.52-9.46) kW Klasa e efijencës SCOP/SEER: (4.0/A+) / (6.4/A++) Rrymimi i ajrit Indoor (H/M/L): 1090/770/610 m3/h Niveli i presionit të zërit Indoor (H/M/L/S): 46/37/34.5/21 dB Dimensionet e njësive Indoor (WxDxH): 1083x396x244 mm Dimensionet e njësive Outdoor (WxDxH): 890x673x342 mm Lloji i refrigerantit: R32 Gypat e refrigerantit (lënë/gazët): Ø6.35/12.7 mm Pesha neto e njësive Indoor: 13.6/17.3 kg Pesha neto e njësive Outdoor: 43.9/46.9 kg Temperatura e jashtme për ftohje/ngrohje: -15°/50/-15°/24 °C	Copë	2.00	€ 1,500.00	€ 3,000.00
2	Furnizimi dhe montimi i njësive të brendshme dhe jashtme individuale për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, prodhuesi Midea ose të ngjajshme me karakteristika: SPLIT UNIT DC INVERTER Modeli Indoor/Outdoor: MSAGCU-18HRFNX / MOX301-18HFN8 Furnizim me energji elektrike (V/Ph/Hz) (Indoor): 230, 1+N, 50 Kapaciteti nominal për ftohje (min-max): 5.27 (1.93-6.27) kW Kapaciteti nominal për ngrohje (min-max): 5.57 (1.28-7.00) kW Klasa e efijencës SCOP/SEER: (4.0/A+) / (7.0/A++) Rrymimi i ajrit Indoor (H/M/L): 800/600/500 m3/h Niveli i presionit të zërit Indoor (H/M/L/S): 41/37/31/20 dB Dimensionet e njësive Indoor (WxDxH): 969x320x241 mm Dimensionet e njësive Outdoor (WxDxH): 805x554x330 mm Lloji i refrigerantit: R32 Gypat e refrigerantit (lënë/gazët): Ø6.35/12.7 mm Pesha neto e njësive Indoor: 11.2/14.6 kg Pesha neto e njësive Outdoor: 33.5/36.1 kg Temperatura e jashtme për ftohje/ngrohje: -15°/50/-15°/24 °C	Copë	3.00	€ 1,200.00	€ 3,600.00



13 PUNËT E LLAMARINËS						
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi		Shuma
1	Furnizimi dhe montimi i ujëmbledhësit (ullukut) horizontal. Ulluku horizontal të punohet nga lamarina e plastifikuar me trashësi t=0.70 mm dhe me dimensione min. 120mm. Në këtë pozicion të përfshihet lidhja në mes të ujëmbledhësit horizontal dhe atij vertikal me "hinkë", gjithashtu shtangimi i ujëmbledhësive horizontal min. çdo 1000 mm. Përdoret te objekti ekzistues dhe te depoja e anex-it.	m'	19.00	€ 7.00	€	133.00
2	Furnizimi dhe montimi ujëmbledhësit (ullukut) vertikal. Ujëmbledhësi të punohet nga lamarina e plastifikuar me trashësi t=0.70 mm dhe me dimensione min. Ø120 mm. Në këtë pozicion të përfshihet lidhja në mes të ujëmbledhësit horizontal dhe atij vertikal me "hinkë", gjithashtu shtangimi i ujëmbledhësive vertikal min. çdo 2000 mm.	m'	42.00	€ 8.00	€	336.00
3	Furnizimi me material dhe mbullimi i pikoreve të atikave nga lamarina e çelikut e plastifikuar t=0.8mm me gjerësi 30x150cm, ngjyra sipas projektit. Në çmim të parashihet punimi i ganqave ankeruese në atikë, ngjitësi/silikonit Sika, aksoret dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion me detaje sipas projektit dhe udhëzimeve nga prodhues të certifikuar. Lamarina në rrafshin ku përkohet nga uji nuk duhet të vrimohet. Përdoret te objekti ekzistues, te parahyja e teatrit dhe te depoja e anex-it.	m'	138.40	€ 8.00	€	1,107.20
4	Furnizimi, transportimi dhe vendosja e mbajtësve të botes të punuar prej metalit të zinkuar të dedikuar për mbulesën përkatëse.	m ²	40.00	€ 6.00	€	240.00
nëntotali						€ 1,816.20

14 PUNËT E NIVELIZIMIT (ESTRIHUT)						
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi		Shuma
1	Furnizimi, transporti me material si dhe punimi i shtresës rrafshuese nga betoni gjysëm i terur me fibra në dysheme me trashësi min. 5 cm për mbrojtjen e termozollimit, pozicioni përfshinë foljen e PVC-së dhe termozollimin stirodur t= 3+2cm. Vërejtje të ketë lidhshmëri me dyshemetë e hapësirave ekzistuese.	m ²	263.70	€ 10.00	€	2,637.00
2	Furnizimi, transporti me material si dhe punimi i shtresës rrafshuese nga betoni gjysëm i terur me fibra në dysheme me trashësi min. 5 cm për mbrojtjen e termozollimit, pozicioni përfshinë foljen e PVC-së dhe termozollimin termodur t= 3+2cm. Përdoret te pllaka përfundimtare	m ²	128.50	€ 10.00	€	1,285.00
nëntotali						€ 3,922.00

15 PUNËT E DYSHEMËSË						
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi		Shuma
1	Furnizimi, transporti me material dhe vendosja e laminatit të tipit AC4 me shtresën përcjellëse me t=10mm i rezistueshëm nga lagështia dhe abrazioni. Përzgjedhjen e tij (dizajnin dhe ngjyrën) e bënë AK. Në çmim përfshihen edhe listelat këndore.	m ²	121.50	€ 13.00	€	1,579.50
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave nga graniti artificial - gres porcelan t= 10mm për dyshemenë e objektit. Në llog. hyjnë të gjitha shtresat përcjellëse, si dhe cokëlla me lartësi h=10 cm me llajsnën përfunduese nga PVC-ja. Ngjyrën dhe dizajnin e zgjedh investitori	m ²	120.50	€ 15.00	€	1,807.50
nëntotali						€ 3,387.00



16 PUNËT E NDRYSHME						
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma	
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i pragjeve të dritareve nga mermeri kualitativ me trashësi 2cm dhe gjëresi 15cm deri në 20cm në të dyja anët e murit (brenda dhe jashtë kthinave - dritareve) . Ngjyra dhe lloji zgjidhet nga AK.	m ²	36.00	€ 16.00	€	576.00
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i granitit kualitativ me trashësi 2cm dhe gjëresi 40cm te atika e anex-it. Ngjyra dhe lloji zgjidhet nga AK.	m ²	32.50	€ 60.00	€	1,950.00
3	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave të granitit për hapësira të shkallëve dhe pushmoreve të trashësisë t=2cm. Strukturë të lëmuar dhe me përmbajtje antislip. Pllakat e granitit të jenë të klasit të parë , ngjyrën dhe tipin e zgjedh AK . Montimi të bëhet me laç çimento . Në çmim të parashihen edhe këndoret periferike (në mure) nga graniti në lartësi 10 cm të përfundura me këndore nga alumini . Prapërkishtë demontimi i pllakave ekzistuese dhe gardhit . Të parashihet edhe nivelizimi i tyre nëse është e nevojshme .	m ²	13.15	€ 60.00	€	789.00
4	Furnizimi me material dhe vendosja e pllakave të granitit natyral të kualitetit të parë të cilat duhen të jenë rezistente në rreshqije, joabsorbuese, rezistente ndaj abrazionit me t=3 cm në hyrjet e objekteve , ndërsa balloret e shkallëve t=2cm. Në çmim të parashifet edhe ngjitësi i pllakave të granitit si dhe këndoret periferike (në mure) nga graniti në lartësi 10 cm. Prapërkishtë demontimi i pllakave ekzistuese , si dhe të llogaritet edhe nivelizimi nëse është e nevojshëm .	m ²	28.00	€ 85.00	€	2,380.00
5	Furnizimi me material dhe vendosja e pllakave të granitit natyral të kualitetit të parë , të jenë të qëndrueshme në ambientin e jashtëm , po ashtu të jenë rezistente në rreshqije , joabsorbuese , rezistente ndaj abrazionit me t=1 cm . Përdoren në nivelin mbi pllakën mbi përdhese të anex-it . Në çmim të parashifet edhe ngjitësi i pllakave të granitit si dhe këndoret periferike (përgjatë murit të atikës) nga graniti në lartësi 10 cm .	m ³	128.50	€ 20.00	€	2,570.00
5	Demontimi i ulëseve të teatrit dhe rimontimi i tyre pas vendosjes së tepihut të ri	copë	231.00	€ 3.00	€	693.00
6	Demontimi i tepihut ekzistues dhe bartja e tij në vendin ku e cakton AK	m ³	210.00	€ 2.00	€	420.00
7	Furnizimi, transporti dhe montimi i tepihut të kualitetit të lartë me të gjitha elementet tjera përcjellëse duke përfshirë edhe ngjitësin dhe lajset dekorative nga alumini (posaqërisht përdoren te disnivelet - shkallët) . Nuancën e cakton AK	m ²	210.00	€ 8.00	€	1,680.00
8	Furnizimi, transporti dhe punimi i sportelit (biletarisë) nga materiali PVC (nuancë , apo strukturë druri) me dim. 200x180 (cm) dhe lartësi 300 cm , me gjatësi perimetrike 560cm (në pjesën prapa ankerohet në murin ekzistues). Profilat të jenë standarde , pjesa e poshtme e dizajnuar me panele nga PVC -ja , kurse pjesa e sipërme e qelqëzuar . Qelqit të jetë transparent / kromopan 4+16+4 mm . Biletaria të ketë derën me mekanizmin për hapje dhe mbyllje , me dorëz të kualitetit të lartë dhe për mbyllje me qels . Pjesa nga parahyrja e biletarisë të ketë mekanizmin (sistemin) për hapje dhe mbyllje të xhamit (qelqit) e inkorporuar në dritare për dhënie e biletave , përkatësisht mekanizmin rrëshqitës si dhe të ketë të montuar pultin me gjëresi min. sa trashësia e murit . Parapërkishtë të bëhet preja e murit ekzistues (nga tullat) me pajisje adekuate dhe të llogaritet punimi dhe montimi i dritares me profile standarde . Dimensoni i dritares 80x80(cm)	copë	1.00	€ 850.00	€	850.00
9	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave gjysëm rrethore Ø400mm nga materiali stiropor i akriluar dhe i zalluar i dekoruar me kanelura . Montimi në murin ekzistues të bëhet me ngjitës adekuat si dhe duke përdorur tiplat adekuate . Modelin dekorativ e zgjedhë AK. Të përpunohen me ngjyrë deri në finalizim .	m ²	24.00	€ 35.00	€	840.00
